



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.Shk II.nr.118/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Dytë, Departamenti i Përgjithshëm, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami në çështjen përmbarimore të kreditorit NGO “Caritas Sëitzerland”, me seli në Prishtinë, rruga “Fazli Balaj”, Kalabria, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Visar Ostrozubi, avokat në Prizren, kundër debitorit “JEGE” SH.P.K., me NRB:810972069, me seli në Prizren, rruga “Besim Shala” p.n, të cilin sipas autorizimit e përfaqësojnë Nafije Muqaj dhe Driton Shehu, avokat në Prizren, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.174/23 të datës 31.08.2023, me datë **04.06.2024**, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e debitorit “JEGE” SH.P.K., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.174/23 të datës 31.08.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin KPPP.nr.174/23 të datës 31.08.2023, ne dispozitiv të aktvendimit ka refuzuar si te pabazuar prapësimin e debitorit “JEGE” SH.P.K., i ushtruar kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr.30/2023 të datës 12.01.2023, të Përmbaruesit Privat Rushit Hoxha.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori nëpërmjet përfaqësuesit të tij të autorizuar, (*me pretendime sikur në ankesë*) duke kërkuar nga gjykata e shkallës së dytë të anuloj vendimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.174/23 të datës 31.08.2023, dhe të bie vendim që edhe njëherë të shqyrtohet lënda në gjykatë. Mbi arsyet e lartcekura ka kërkuar nga gjykata të vendos si në propozimin e lartpërmendur.

Kreditori ka ushtruar përgjigje ne ankesë nëpërmjet së cilës ka theksuar se dokumenti në bazë të cilit është marrë vendimi përmbarues ose urdhri përmbarues gjegjësisht Marrëveshja për

Pengun mbi bazën e të cilës është bërë regjistrimi i pengut në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, paraqet titull ekzekutiv, andaj ka kërkuar nga gjykata e shkallës së dytë që ankesën e debitorit ta refuzoj në tërësi si të pabazuar.

Ankesa e debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se Përmbaruesi Privat duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar urdhrin përmbarimor P.nr.30/2023 të datës 12.01.2023, me të cilin ka lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit përmbarimor – Kontratës mbi Pengun të datës 15.02.2022, ndaj sendit të luajtshëm pengut Makina “Valum Avullues” me nr. serik: ATK – DK05.01, viti i prodhimit 2019, i regjistruar si peng në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë sipas konfirmimit dhe Certifikatës së regjistrimit të pengut me nr.R-20220325-443, të datës 25.03.2022, e vlerësuar në shumën prej 75,000.00 € sipas raportit të vlerësimit të datës 04.02.2022 të punuar nga eksperti A.Sh., ashtu që e njëjta të konfiskohet dhe të nxirret në ankand publik për shitje dhe nga realizimi i mjeteve nga shitja e saj, kreditorit të i kthehet shuma prej 25,045.00 € si dhe pagimin e shpenzimeve procedurale, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të urdhrin nën kërcënim të pasojave ligjore në rast të tjetërsimit, asgjësimit apo fshehjes së pasurisë në dëm të kreditorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor me arsyetimin se dokumentet e bashkangjitura propozimit për përmbarim nuk përmbajnë titull ekzekutiv e as dokument të besueshëm, por vetëm një marrëveshje dhe një dokument të vërtetimit të nënshkrimit të palëve. Tutje ka shtuar, se këto dokumente nuk janë të përshtatshme për përmbarim, pasi që nuk përmbajnë asnjë objekt, mjete, shumën dhe kohën e përmbushjes së detyrimit. Gjykatës i ka propozuar që të aprovohet prapësimi i debitorit, të shfuqizohet Urdhri Përmbarimor P.nr.30/2023 i datës 12.01.2023 dhe të obligohet kreditori që t’ia paguaj shpenzimet për përpilimin e prapësimin në shumën prej 312 € dhe taksës gjyqësore sipas Tarifës së OAK-së.

Kreditori në përgjigjen në prapësim ka deklaruar se, propozimi për përmbarim përmban dokumentin përmbarimor konform nenit 27 të LPP-së, pasi që në të është përcaktuar kreditori, debitori, shuma e detyrimit e cila duhet të i kthehet kreditorit për shkak të mospërmbushjes së obligimit të tij, pengun si objekt i përmbarimit dhe dokumenti është bashkangjitur në origjinal. Gjykatës i ka propozuar që ta refuzoj si të pabazuar prapësimin e debitorit ndërsa Urdhri Përmbarimor P.nr.30/2023 i datës 12.01.2023 të mbetet në fuqi

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, pas vlerësimit të prapësimin, përgjigjes në prapësim dhe shkresave në lëndë, ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.174/23 të datës 31.08.2023, me të cilin ka refuzuar si të pabazuar prapësimin

e debitorit “JEJE” SH.P.K., i ushtruar kundër Urdhrit Përmbarrimor P.nr.30/2023 të datës 12.01.2023, të Përmbarruesit Privat Rushit Hoxha.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka vlerësuar se dokumenti përmbarrues përbën bazë juridike për caktimin e përmbarrimit, ngase i kanë plotësuar kushtet ligjore nga neni 27 të LPP-së, për të qenë i përmbarrueshëm dhe njëkohësisht i përshtatshëm për përmbarrim.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka marr aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, i njëjti është i kuptueshëm dhe i qartë, prandaj vendimin e gjykatës, lidhur me këtë çështje e pranon edhe kjo gjykatë, duke vlerësuar se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar drejtë faktin se baza juridike për caktimin e përmbarrimit, kushtet ligjore që duhet të plotësohen për të caktuar përmbarrimin sipas dokumentit të përmbarrimit, parashihen sipas dispozitës së nenit 22 par.1 nën par 1.7 i Ligjit për Procedurën Përmbarrimore, Ligjit për Procedurën Përmbarrimore, nr.05/L-118 të, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore ku në mesin e dokumenteve përmbarrimore në bazë të cilave organi përmbarrues mund të caktoj përmbarrimin është edhe kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut.

Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerëson se dokumenti në bazë të cilit është lejuar urdhri përmbarrimor paraqet dokument përmbarrimor, për faktin se në rastin konkret përmbarruesi privat e ka lejuar përmbarrimin duke u bazuar në Kontratën mbi Pengun të datës 15.02.2022, ndaj sendit të luajtshëm pengut Makina “Valum Avullues” me nr. serik: ATK – DK05.01, viti i prodhimit 2019, i regjistruar si peng në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë sipas konfirmimit dhe Certifikatës së regjistrimit të pengut me nr.R-20220325-443, të datës 25.03.2022, dhe e njëjta paraqet dokument përmbarruese në kuptim të dispozitës së nenit 22 par.1 nën par 1.7 i Ligjit për Procedurën Përmbarrimore, me të cilën parashihet se “1. *Dokumente përmbarruese janë 1.7. kontrata për hipotekën e vërtetuar nga organi kompetent dhe regjistruar në regjistrin publik sipas ligjit*” ndërsa me ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore me nenin 5 përcaktohet si në vijim” 2. *Neni 22 i ligjit bazik, paragrafi 1., pas nën-paragrafit 1.7., shtohet nën-paragrafi i ri 1.7a. me tekstin si në vijim. 1.7a. kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut.*

Andaj, Marrëveshja për Pengun është regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pengut në Ministrinë e Trgtisë dhe Industrisë dhe si e tillë paraqet titull përmbarimor në pajtim me dispozitat e lartcekura.

Gjykata e shkallës së dytë ka analizuar edhe pretendimet tjera të debitorit por të njëjta mbasin vetëm në natyrën deklarative dhe të pambështetura në prova konkrete siç parasheh dispozita 69 par.4 të LPP dhe si të tilla nuk janë relevante për vendosje ndryshe prandaj kanë rezultuar si të pathemelta të cilat gjykata ankimore vendosi të refuzojë ndërsa aktvendimin e atakuar vendosi ta vërtetojë.

Përndryshe, në procedurën përmbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,
Dhomat e Shkallës së Dytë,
K.DH.SH.II nr.118/24 me datë 04.06.2024**

**Gjyqtari,
Faton Bajrami**